



OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 10

27 janar 2024

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
		8 pikë	8 pikë	10 pikë	10 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. "Versionet e Hitlerit mendoj se ishin dy. Në një pikëpamje ai donte një luftë të madhe me synimin për ta shndërruar Gjermaninë në fuqinë më të madhe në botë, dhe ai vet në pushtuesin më të madh të botës si Aleksandër i Madh apo Napoleoni. Ai ishte maniak. Këndvështrimi tjetër e bën atë më racional. Në këtë pikëpamje, Hitleri kishte një plan koherent afatgjatë të cilin e ndoqi me këmbëngulje të palëkundur. Ai synonte ta shndërronte Gjermaninë në një perandori koloniale në Evropën Lindore duke mundur Rusinë Sovjetike, duke shfarosur të gjithë banorët e saj dhe duke planifikuar të mbushte territoret bosh me popullsi gjermane. Sigurisht nëse Hitleri po planifikonte të fitonte një luftë të madhe kundër Rusisë Sovjetike, lufta e tij kundër Fuqive perëndimore ishte një gabim."

A.J.P. Taylor "Origins of the Second World War", 1991

- a) Analizoni shkaqet e Luftës II Botërore.

5 pikë

- Problemet e krijuara nga Traktati i Paqes në Paris, veçanërisht pakënaqësia e gjermanëve shkaktuar nga kushtet e ashpra të Traktatit të Versajës.
- Dështimi i Lidhjes së Kombeve për të trajtuar me efektivitet problemet, veçanërisht aktet agresive të shteteve si Gjermania, Italia e Japonia.
- Krize ekonomike botërore që arriti kulmin me rënien e Bursës së New York, dhe që luajti një rol të madh duke mundësuar ardhjen në pushtet të diktatorëve fashistë.
- Frika nga komunizmi që ndihmoi në ngritjen e diktaturave fashiste në Itali dhe Gjermani dhe parandaloi në mënyrë efektive një aleancë mes Britanisë, Francës dhe BS kundër agresionit gjerman.
- Tolerimi nga ana e Francës dhe Britanisë së Madhe, që i dha mundësi Hitlerit të shkelte kufizimet e vendosura nga Traktati i Paqes dhe të krijonte një forcë të madhe dhe të armatosur, duke i forcuar besimin se mund të kryente akte provokuese pa hasur në kundërshti.
- Gatishmëria e Stalinit për të firmosur Paktin Nazi-Sovjetik që i siguroi Gjermanisë naziste qetësinë në krahun lindor, duke e lejuar atë të përqendronte fuqinë ushtarake në Perëndim.
- Gjermania argumentonte se kishte një pretendim për Sudetet, Gdanskun dhe akseset në korridorin polak, por vendimi i Hitlerit për të marrë gjithë Çekoslovakinë dhe pushtuar Poloninë e bënin luftën të pashmangshëm.

- b) Blitzkrieg që do të thoshte "Luftë rrufe" u përdor për të përshkruar taktikën e suksesshme të përdorur nga gjermanët në fillim të luftës. Hitleri kishte nxjerr mësim nga Lufta I Botërore dhe ishte i vendosur të shmangte luftën në llogore. Blitzkrieg ishte bazuar në dy armë: aeroplanë dhe tanke. Kjo taktikë rezultoi e suksesshme për Gjermaninë.

Shpjegoni tri nga sukseset e kësaj taktike.

3 pikë

- Ishte një taktikë e re e panjohur. Aleatët, veçanërisht Franca dhe Britania, besonin se do të ishte një luftë si ajo e viteve 1914-1918. Për këtë arsye në muajt e parë të luftës ata qëndruan në pozita mbrojtëse.
- Ajo u zhvillua shumë shpejt dhe nuk i dha mundësi kundërshtarëve të rimarrin veten.
- Gjermanët i përdorën tanket e tyre në grupe të mëdha në disa vende. Edhe pse Britania dhe Franca humbën shumë tanke, ato i ndanë tanket e mbetura në grupe të vogla duke i përhapur në të gjithë vijën e sulmit.
- Franca ishte e sigurtë nga sulmi gjerman për shkak të vijës Mazhino, një linjë fortifikimesh që kishin ndërtuar në 1930. Ajo shtrihej përgjatë kufirit gjerman, nga Zvicra në Belgjikë. Francezët besonin se ishte e pamundur për këdo ushtri pushtuese të thyente këtë varg fortesash që lidheshin nga tunele të nëndheshme.

2. "Nacionalizmi midis kombeve është si racizmi midis racave. Racizmi dhe nacionalizmi janë forma fisnore. Tribalizmi gjithmonë, gjithmonë çon në luftë. Pse? Sepse çdo komb mendon se është superior ndaj kombeve të tjera dhe interesi i tyre vetjak është më i rëndësishëm se interesi vetjak i kombeve të tjera."

Oliver Markus Malloy, Fashizmi Amerikan: Paralajmërimi urgjent i një shkrimtari gjerman për Amerikën, 2019

- a) Identifikoni dy elementë përbërës të nacionalizmit si koncept. **2 pikë**
- Identifikimi i kombit me shtetin.
 - Besnikëria ndaj kombit.
 - Sovraniteti kombëtar.
 - Kultura kombëtare.
 - Superioriteti ndaj kombeve të tjera (element me ndikim negativ).
- b) Përshkruani dy ndryshime të rëndësishme në politikën ose shoqërinë evropiane të shkaktuar nga nacionalizmi në Evropë gjatë periudhës 1900-1950. **2 pikë**
- Nacionalizmi dhe rivalitetet kombëtare çuan në dy konflikte evropiane të mëdha dhe shumë shkatërruese (luftërat botërore).
 - Nacionalizmi inkurajoi kontroll më të madh të qeverisë mbi shoqërinë qeverisjet totalitare.
 - Nacionalizmi kontribuoi në shpërbërjen e disa perandorive multietnike (Austro-Hungaria, Perandoria Osmane) në fund të Luftës I Botërore dhe humbja e territorit nga të tjerët (p.sh. Gjermania dhe Rusia humbën territorin ndaj Polonisë).
 - Nacionalizmi çoi në krijimin e shteteve të reja në Evropën Lindore në fund të Luftës I Botërore.
 - Rritja e nacionalizmit dhe lëvizjet për pavarësi në kolonitë evropiane detyruan ndryshime në politikën e brendshme në Evropë pasi vendet e ndryshme evropiane u përballën me humbjen e mundshme të kolonive të tyre.
- c) Shpjegoni dy mënyra nëpërmjet të cilave nacionalizmi çoi në një ndryshim në politikën ose shoqërinë evropiane gjatë periudhës 1950-2000. **2 pikë**
- Teprimet e nacionalizmit e diskredituan atë në sytë e shumë njerëzve pas Luftës së Dytë Botërore dhe inkurajuan mbështetjen për organizata shumëpalëshe si OKB-ja.
 - Në reagim ndaj politikës nacionaliste dhe luftës, qeveritë e Evropës Perëndimore nxitën krijimin e Bashkimit Evropian.
 - Bashkimi Sovjetik u përpoq të shtypte nacionalizmin në bllokun lindor.
 - Me rënien e Bashkimit Sovjetik, disa vende multietnike në Evropën Lindore u ndanë në vende më të vogla në bazë të kombësisë (Çekosllovakia, Jugosllavia).
 - Në disa zona të Evropës, pakicat kombëtare brenda shteteve ekzistuese filluan të agjitojnë për autonomi ose pavarësi (Katalanët, Baskët, Skocezët, Irlandezët).
- d) Shpjegoni dy mënyra nëpërmjet të cilave nacionalizmi kontribuoi në një vazhdimësi në politikën ose shoqërinë evropiane gjatë periudhës 1950-2000. **2 pikë**
- Nacionalizmi vazhdoi të ushqejë konfliktin, si në shpërbërjen e Jugosllavisë ose në periudhën e ashtuquajtur "Troubles" në Irlandën e Veriut.
 - Migrimi vazhdoi të ishte një çështje e diskutueshme në vendet evropiane, duke ngritur çështje të identiteteve kombëtare dhe fetare.
 - Kombësia vazhdoi të ishte një komponent i rëndësishëm i identitetit të shumicës së njerëzve në Evropë, pavarësisht organizatave dhe ideologjive transnacionale dhe pavarësisht globalizimit dhe ndërlidhjes më të madhe.
 - Pavarësisht ndryshimeve në kufij, shteti-komb vazhdoi të ishte baza kryesore për sistemet dhe strukturat politike të Evropës në periudhën e pasluftës.

3. Plot 100 vite e ndajnë Revolucionin e Lavdishëm nga Revolucioni Francez, me një kontekst shumë të ndryshëm gjeografik dhe historik mes tyre. Për pasojë, ata paraqesin aspekte të ndryshme mes njeri-tjetrit, megjithëse secili mund të konsiderohet si një revoltë ndaj mbizotërimit të monarkisë absolute.

Analizoni në formën e një eseje ndryshimet mes rrjedhojave politike të Revolucionit të Lavdishëm në Angli dhe Revolucionit Francez.

10 pike

Pika orientuese ku duhet të mbështetet eseja

- Revolucionin e Lavdishëm (1688) në Angli më në fund konsolidoi kompetencat e degës legjislative të qeverisë (në këtë rast, parlamentit) mbi ekzekutivin (mbreti James.)
- Ky proces që kufizonte ekzekutivin filloi me Magna Carta në 1215, e cila dobësoi "Të Drejtën Hyjnore të Mbretërve" dhe përfundoi në këtë kohë. Revolucionin ishte "i lavdishëm" sepse sundimi i ligjit përmes parlamentit rrëzoi mbretin, pa gjakderdhje dhe luftë siç ndodh zakonisht.
- Francezët, u përpoqën për një shtet ligjor me anë të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut, të modeluar disi sipas Deklaratës Amerikane të Pavarësisë.
- Megjithatë, Revolucioni Francez kaloi në gjakderdhje, luftë klasore, regicide dhe dështim, gjë që krijoi një mundësi që Napoleoni të bëhej perandor.
- Pas Napoleonit, Franca më në fund fitoi një masë të demokracisë së stilit britaniko-amerikan shumë vite pas revolucionit të saj.

4. Midis viteve 1945 dhe 1950, aleanca e kohës së luftës midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik u ndërpre dhe filloi Lufta e Ftohtë. Për 40 vitet e ardhshme, marrëdhëniet midis dy superfuqive u lëkundën midis konfrontimit dhe qetësisë. Secili u përpoq të rriste ndikimin e vet mbarë botëror dhe të përhapte sistemet e veta konkurruese ekonomike dhe politike.

Analizoni në formën e një eseje ndikimin e Luftës së Ftohtë në arenën ndërkombëtare.

10 pike

Pika orientuese ku duhet të mbështetet eseja

- Peizazhi politik global u riformua rrënjësisht gjatë Luftës së Ftohtë, ndërsa dy superfuqitë luftuan për ndikim dhe kontroll mbi kombet e tjera.
- Një nga pasojat më domethënëse të Luftës së Ftohtë ishte ndarja e botës në dy blloqe, me fuqitë perëndimore dhe aleatët e tyre që formuan botën e parë kapitaliste, dhe Bashkimin Sovjetik dhe aleatët e tij që formuan botën e dytë socialiste. Bota e Tretë iu referua kombeve të paangazhuara që kërkuan të qëndronin neutral dhe të mos merrnin anë në konflikt.
- Lufta e Ftohtë u karakterizua nga një seri luftërash të ashtuquajtura "me prokurë", si Lufta e Koresë, Lufta e Vietnamit dhe Lufta Sovjeto-Afgane, në të cilën të dy superfuqitë mbështetën palët kundërshtare.
- Gara e armatimeve midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik pati gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në politikën dhe ekonominë globale. Të dy vendet investuan shumë në teknologjinë ushtarake, duke rezultuar në zhvillimin e sistemeve gjithnjë e më të sofistikuar të armëve dhe përhapjen e armëve bërthamore.
- Lufta e Ftohtë pati gjithashtu një ndikim të thellë në kulturë dhe shoqëri, me të dyja palët që përdorën propagandën për të promovuar ideologjinë dhe vlerat e tyre.
- Gara hapësinore ishte një shembull i dukshëm i kësaj, me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Sovjetik që konkurronin për të arritur piketa të rëndësishme në eksplorimin e hapësirës.
- Rënia e Bashkimit Sovjetik në vitin 1991 shënoi fundin e Luftës së Ftohtë dhe pasojat e saj patën pasojat të rëndësishme për politikën globale. Shtetet e Bashkuara u shfaqën si superfuqia e vetme në botë dhe komuniteti ndërkombëtar hyri në një epokë të re të politikës globale, e karakterizuar nga globalizimi, përhapja e demokracisë dhe ngritja e fuqive të reja ekonomike si Kina.

5. Gjatë Luftës I Botërore disa politikanë (Lloyd Xhorxh dhe Udro Uillson) filluan të diskutojnë për rrugët që duhet të ndiqnin për të shmangur një konflikt tjetër ndërkombëtar. U hodhën ide për krijimin e një organizate me bazë të gjerë që do të trajtonte një gamë të gjerë problemesh ndërkombëtare dhe do të mblidhej për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe krizat. U krijua kështu Lidhja e Kombeve.

a) Cili ishte qëllimi kryesor i Lidhjes së Kombeve?

2 pikë

Qëllimi kryesor ishte ruajtja e paqes botërore dhe përpjekja për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar në shkallë të gjerë ekonomike e sociale, duke përfshirë çarmatimin.

b) Organet kryesore të Lidhjes ishin: Asambleja, Këshilli dhe Sekretariati. Cilat ishin funksionet e secilit organ?

6 pikë

Asambleja mblidhej një herë në vit, Çdo anëtar kishte të drejtën e një vote. Shqyrtonte çështje të politikës së përgjithshme. Kontrollonte buxhetin e Lidhjes. Pranonte anëtarët e rinj dhe zgjidhte anëtarët e përkohshëm të Këshillit.

Këshilli ishte organi kryesor i Lidhjes. Mblidhej katër ose pesë herë në vit dhe në kohë krizash. Kishte anëtarët e përhershëm dhe të përkohshëm

Sekretariati ishte organ administrativ i Lidhjes. Kryente të gjitha punët administrative dhe financiare. Organizonte konferenca, shpërndante agjenda, monitoronte buxhetin, publikonte raportet.

c) Analizoni qëndrimin e SHBA, Gjermanisë dhe BRSS ndaj Lidhjes së Kombeve.

6 pikë

SHBA

Edhe pse presidenti Uillson ishte një nga ideatorët e Lidhjes së Kombeve, SHBA refuzoi t'i bashkohej Lidhjes, sepse shumica në Senatën amerikan mendonin se anëtarësimi do t'i përfshinte amerikanët në të ardhmen në luftë dhe mosmarrëveshje. Mospjesëmarrja e SHBA ishte një mangësi e madhe e Lidhjes, duke e privuar atë nga shteti më i fuqishëm, më me influencë dhe më i pasur në botë.

Gjermania

Gjermania nuk u lejua të anëtarësohej derisa ajo të tregonte synime paqësore. Kjo krijoi efektin e gabuar se Lidhja s'ishte gjë tjetër veç një klub i shteteve fituese i lidhur me Traktatin e Versajës. Gjermania u lejua të anëtarësohej në 1926 dhe u bë anëtar i përhershëm i Këshillit. Por në 1933 me ardhjen në pushtet të Adolf Hitlerit një nga aktet e para të firmosura ishte largimi nga Lidhja.

Bashkimi Sovjetik

BS nuk u ftua t'i bashkohej Lidhjes kryesisht për arsye ideologjike pasi ishte vend komunist i përkushtuar për përmbysjen e kapitalizmit. As vet BS nuk kishte kërkuar t'i bashkohej kësaj Lidhje, pasi disa nga shtetet (Britania dhe Franca) kishin ndihmuar në mënyrë aktive kundër Revolucionit gjatë Luftës Civile në Rusi (1918-1921). Në fund të viteve '20 kishte një tolerancë nga të dy palët dhe në 1934 iu bashkua Lidhjes, për t'u dëbuar 1939 pas pushtimit të Finlandës.